



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

**Komuna e Kaçanikut**

Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit



01Nr. 104/02-21330/24

Kaçanik, 02.09.2024

Në bazë të nenit 14, nenit 17 (k) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6 (l) të Statutit të Komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas Statutit 01Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.3558/2008 të datës 25.09.2008, Ligjit Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.23/2010 Për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.21/2010 Për Përcaktimin e Radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Komuna e Kaçanikut bënë këtë:

**SHPALLJE PUBLIKE**

**Për aplikim në kuadër të Programit trevjeçar të Banimit për familjet me kushte të rënda sociale dhe ekonomike, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.**

**1. Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit janë:**

- 1.1 Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
- 1.2 Familjet që kanë mbetur pa banesë-shtëpi si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë;
- 1.3 Familjet të cilat posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

**2. Kriteret bazë për përcaktimin e radhës së përparësisë:**

- 2.1. Statusi i banimi;
- 2.2. Lartësia e të ardhurave;
- 2.3. Gjendja shëndetësore;
- 2.4. Invaliditeti;
- 2.5. Struktura e familjes.
- 2.5.1 Struktura e familjes përbën kriter përparësie shtesë kur familja është:

1. Familje dëshmorë;
2. Familje e kryesuar nga një prind;
3. Familje në përkujdesje të fëmijëve jetim.
4. Familjet të cilat bëjnë kërkesë për të përfitur nga ky program i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, banorë të përhershëm të komunës së Kaçanikut.
5. Numri i njësive të banimit për këtë program të veçantë të banimit janë 36 (tridhjetë e gjashtë), ndërtesa e banimit social gjenden në Fshatin Kaçaniku i Vjetër, të cilat jepen me qira joprofitabile, për kategoritë e familjeve të sipër përmendura.
6. Aplikuesit formën standarde të aplikacionit/kërkesës mund ta marrin në zyrën për kërkesa dhe ankesa, kati përdhese, në ndërtesën e komunës, çdo ditë pune nga ora **08:30** deri në ora **15:30**.
7. Aplikacioni/kërkesa i plotësuar së bashku me dokumentet e nevojshme të bashkëngjitura dorëzohen në zyrën për kërkesa dhe ankesa, kati përdhese, në ndërtesën e komunës, çdo ditë pune nga ora **08:30** deri në ora **15:30**.
8. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të bashkëngjitet aplikacioni/kërkesës janë:

1. Fotokopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës;
2. Certifikatat e lindjes për anëtarët e familjes të parashtruesit të kërkesës;
3. Certifikatat familjare;
4. Vërtetim (informatë) mbi vendbanimin e përhershëm;
5. Të dhënat për anëtarët e punësuar (nga punëdhënësi) dhe burimet e të hyrave të rregullta;
6. Vërtetim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (në komunë në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik) që personi kërkues dhe anëtarët e familjes nuk kryejnë aktivitet tregtar;
7. Vërtetim nga Enti për punësim për të gjithë anëtarët e familjes të papunë;
8. Vërtetim mbi shkollimin e rregullt;
9. Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës apo të anëtarëve të familjes, të lëshuar nga ana e enteve shëndetësore të autorizuara ose të komisioneve profesionale;
10. Vërtetim për dëshminë lidhur me statusin e familjes së dëshmorit;
11. Vërtetim nga autoritetet përkatëse për dëshminë për përkujdesje ndaj fëmijëve jetim;
12. Dokumentet shtesë të nevojshme sipas rasteve.

9. Afati për paraqitjen e aplikacioneve/kërkesave do të jetë 30 ditë, nga dita e publikimit të shpalljes.
10. Pas mbylljes së afatit për dorëzimin e aplikacioneve/kërkesave, Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve bënë vlerësimin me pikë sipas kritereve të përcaktuara në shtojcën Nr.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.



11. Komisioni në terren bënë vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve si dhe verifikimin e të dhënave të kërkuarve në terren brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

12. Kohëzgjatja e përfitimit nga programi i veçantë i banimit është 3 (tre) vite, ndërsa rivlerësimi bëhet çdo 1 (një) vit nga organi kompetent komunal.

13. Përjashtohen nga përfitimi nga këto programe, familjet që kanë përfituar ndihmë në formë të tjera të të njëjtit nivel ose më të lartë se sa mund të përfitohet nga programet e veçanta të banimit.

14. Lista e familjeve përfituese të programit të veçantë të banimit, sipas pikëve të fituara nga vlerësimi i Komisionit përzgjedhës do të publikohet nga komuna në tabelën e shpalljeve. Ndërsa publikimi i të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes është i ndaluar para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura..

15. Aplikacionet/kërkesat e dorëzuara, të pa kompletuara, jashtë afatit kohorë dhe të pa plotësuara me dokumentet e kërkuara nuk do të pranohen nga Komisioni përzgjedhës, meqë rast do të konsiderohen të pavlefshme.

16. Kundër vendimit të Komisionit përzgjedhës, palët kanë të drejtë ankese me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, nga data e publikimit të vendimit.

